



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNO-SNAZNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ / UROSEVAC

P.nr.2636/17

*Dana*  
Dana

15 - 01 - 2018 NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, gjyqtari individual Mustaf Tahiri, me sekretaren juridike Drita Ujupi, në lëndën penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] komuna e [REDACTED], i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.2115-5/17 të dt.23.10.2017 për veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkësen e prokurorisë për dhënen e urdhrit ndëshkimor dënim me gjobë, gjykata me dt. 13.11.2017 mori këtë:

### A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PPK në Ferizaj PP/II.nr.2115-5/17 të dt.23.10.2017 dhe kjo gjykatë jep këtë:

### URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri [REDACTED], nga fsh. [REDACTED] komuna e [REDACTED], i lindur më [REDACTED], nga i ati [REDACTED], i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTORË

Sepse me datën 24.09.2017 rrëth orës 16:30, në pyllin publik, në vendin e quajtur "Te Bashqet", në rajonin ekonomiko-pyjor, Neredime-Jezercë, është takuar duke prerë 50 copë trungje të ahut të njomë, Boniteti III, me diametër 50 centimetra, e me vëllim të përgjithshëm prej 2.50 metra kub e në vlerë prej 337.50 €, drunjë kanë qenë të prerë me sharrë motorike dhe të transportuara me veturë xhip.

me ç 'rast ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,7,17,21,41,46 dhe 73 të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPP-së të pandehurin e :

## GJYKON

Me dënim në gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rastë se dënim me gjobë nuk mundë të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do ti zëvendësohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

Obligohet i pandehuri qe Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari në Ferizaj, ti paguaj shumën në vlerë prej 337.50 €, në afat prej 30 (tridhjetë) dite në emër të dëmit të shkaktuar, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të pashallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 20 €, në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

## Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.2115-5/17 të dt.23.10.2017 ka akuzuar të pandehurin [REDACTED] për vepër penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor PP/II.nr.2115-5/16 të dt.23.10.2017 me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallximi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.të KPPK-së.

Gjykata duke i shikuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si: fletëparaqitura e rojës së pyllit të Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari në Ferizaj me nr.669/2017 i dt.03.10.2017 dhe procesverbali nga komisioni kompetent për vlerësimin e dëmit me numër të njëjtë, konstatoj se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 463 par.2 të KPPRK-s, është bliguar i pandehuri qe Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari në Ferizaj, ti paguaj shumën në vlerë prej 337.50 €, në emër të dëmit të shkaktuar, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale është marrë në baze të nenit 450 dhe 451 të KPPK-së dhe atë në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 20 € në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ


P.nr. 2636/17 dt.13.11.2017

Sekretare Juridike

Drita Ujupi

Gjyqtari

Mustaf Tahiri



**UDHËZIM JURIDIK:**Kundër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 (tetë) ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, gjyqtarit individual të kësaj gjykate përmes kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor merrë formën e prerë dhe dënimini i shqiptuar ekzekutohet.